/

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. 1165 /16
Nr. i Up. / Br. st
Data / Datum 05.12.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës dhe nenin 5 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014,

# V E N D I M

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE TË KOMUNËS

1. Formohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare të komunës (inventari i administratës së komunës) në këtë përbërje:

   1.1 **Fatmir Feka**, kryesues
   1.2 **Lindita Haradinaj**, anëtare
   1.3 **Mustafë Gjoni**, anëtar

2. Komisioni i cekur në pikën paraprake Komisioni do të kryej inventarizimin në administratën e komunës dhe në Njësinë e Zjarrfikësve në Vushtrri, në pajtim me nenin 5 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore përkatësisht nenin 6 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës.

3. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe të përfundoj punën para datës 31.12.2016.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi iu dërgohet: Drejtorit për buxhet dhe financa, anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
Nr./Br.: 1169/16
Nr.Ref./Br.st.
Datë/Datum: 06.12.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës dhe nenin 5 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014 si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE TË SHËNDETËSISË

1. Formohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare të shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:

   1.1 **Shpresa Merovci**, kryesuese
   1.2 **Nasrije Krasniqi,** anëtare
   1.3 **Fatmire Hajra,** anëtare

2. Komisioni i cekur në pikën paraprake do të kryej inventarizimin në pajtim me nenin 5 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore përkatësisht nenin 6 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës.

3. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe të përfundoj punën para datës 31.12.2016.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi iu dërgohet: Drejtorit për për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtarëve të komisionit dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. Prot./Br. 1170/16
Nr. i Lp./Br. zl.
Datum/Datum: 06.12.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 19 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës dhe nenin 5 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës nr.464/14 dt.20.03.2014 si dhe në bazë të prpozimit të Drejtorisë për Arsim, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR INVENTARIZIM TË PASURISË JO FINANCIARE TË ARSIMIT TË KOMUNËS

1. Formohet komisioni për inventarizim të pasurisë jo financiare të arsimit në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:

   1.1 Enver Bajrami, kryesues
   1.2 Hashim Hajrizi anëtar
   1.3 Bajram Ibrahimi, anëtar

2. Komisioni i cekur në pikën paraprake do të kryëj inventarizimin në pajtim me nenin 5 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore përkatësisht nenin 6 të Rregullës për menaxhimin e pasurisë jo financiare të komunës.

3. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë dhe të përfundoj punën para datës 31.12.2016.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi iu dërgohet: Drejtorit për buxhet dhe financa, Drejtorit të drejtorisë për arsim anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr./Br. 1185/16
Nr.i fq./Br. st.
Data:/Datum 14.12.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M
## PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN E PUNËVE

1. Formoj Komisionin për verifikim të ekzekutimit të punëve në projektin llot 2 – Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Duboc – Galicë, prok. Nr.644-16-150-521 në këtë përbërje:

   1.1 **Agim Radoniqi,** ing. dip. i Arkitekturës, kryesues i komisionit
   1.2 **Egzon Haradinaj,** ing. i Arkitekturës, anëtar
   1.3 **Ramiz Maliqi,** ing. dip. i Arkitekturës, anëtar

2. Komisioni në si në pikën një të këtij vendimi, ka për detyrë të bëjë verifikimin e cilësisë dhe sasisë të punëve të përfunduara sipas përshkrimit të specifikimit teknik të ofertës gjegjësisht pranimin teknik të punëve të kryera në projektin në fjalë, ku kryes i Punëve është Op.Ek. : **NNP " Hysnia " me seli në Vushtrri** , me përfaqësues z. **Hysni Shabani , në bazë të kontratës nr. 846/16 datë 17.10.2016.**

3. Komisioni do të filloi me punë më dt. **15.12.2016 ( e Enjte )** në orën **10.00**, me pjesëmarrjen e Menaxherit të Kontratës – Organit Mbikëqyrës **z. Ahmet Shuku dhe Isa Latifi** si dhe përfaqësuesin e punë kryesit në fjalë.

4. Në bazë të gjendjes së konstatuar komisioni do të hartoi procesverbal në të cilin do të përshkruhet gjendja faktike nëse çdo punë është punuar në përputhje me kontratën në sasi dhe cilësi, ose do të konstatoj të metat dhe parregullsitë nëse ekzistojnë, si dhe do të caktoi afatin për mënjanimin e tyre. Nëse komisioni konstaton se nuk ka të meta, atëherë, nga komisioni, do të lëshohet një ***certifikatë – vërtetim*** mbi rregullsinë e punimeve, të cilin, të nënshkruar nga anëtarët e komisionit, në afatin më të shkurtë kohorë do t'ia dërgoi Kryetarit të Komunës, kryesit të punëve dhe një kopje Drejtorisë për prokurim me qëllim të procedimit të mëtejmë.

5. Vendimi hyn në fuqi dhe do të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

6. Vendimi i dërgohet: Anëtarëve të komisionit, Drejtorisë për Prokurim Publik, Punë kryesit, Menaxherit të Projektit dhe Arkivit të Sekretarisë.

**Shtojcë: Kontrata , përshkrimi i punëve dhe çmimet e kontraktuara.**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E VUSHTRRISË – OPŠTINA VUČITRN – REPUBLIKA KOSOVA

**Kryetari i Komunës**

**Bajram Mulaku**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 1188/16
Nr. i lig. / Br. st
Data: / Datum 15.12.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, dt. 28 tetor 2010, dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, me datën 15.12.2016, merr këtë:

## VENDIM PËRFUNDIMTAR

1. Miratohet shpronësimi për interes publik, realizimin e projektit për ndërtimin me kubëza betoni i trotuarit në rrugën "Arsim Muzaqi, Komuna e Vushtrrisë, të pronave të paluajtshme si në vijim:
   P-70202016-01045-0, në sipërfaqe prej **23 m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 430 m$^2$, ZK-Vushtrri, bashkëpronar në pjesë ideale 1/6 Staletovic Tatijana (Ratko), Petrovic Dosta (Dimitrije), Staletovic Liljana (Ratko), Zivkovic Radmila, Popadic Dragoljub (Dimitrije), Murganic Gordana (Zivojin), nga Vushtrria, Komuna Vushtrri.
   P-70202016-01046-0, në sipërfaqe prej **5m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 217 m$^2$, ZK-Vushtrri pronar me pjesë ideale 1/1 Blerim Krasniqi (Xhemajl) nga Vushtrria, Komuna Vushtrri.
   P-70202016-01047-0, në sipërfaqe prej **27m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 309 m$^2$, ZK-Vushtrri pronar me pjesë ideale 1/1 Murganic Dragisa (Blagoje), nga Vushtrria, Komuna Vushtrri.
   P-70202016-01048-0, në sipërfaqe prej **7m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 141 m$^2$, ZK-Vushtrri pronar me pjesë ideale 1/1 Arif Shatrani (Behram), nga Vushtrria, Komuna Vushtrri.
   P-70202016-01049-0, në sipërfaqe prej **5m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 456 m$^2$, ZK-Vushtrri bashkëpronar me pjesë ideale 1/3 Jeset Rexhepi (Rrahmon), Izet Rexhepi (Rrahmon), Ismet Rexhepi (Rrahmon), nga Vushtrria, Komuna Vushtrri.

2. Për pronat e shpronësuara, do të paguhet kompensimi në emër dhe llogari të secilit pronarë të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi, apo zotëruesit të interesit, në

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
02 Nr./Br 1189/16
Nr. i fq./Br. st.
Data:/Datum 15.12.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIC OF KOSOVA/REPUBLIKA KOSOVA
**KOMUNA VUSHTRRI**
VUSHTRRI MUNICIPALITY /OPSTINA VUCITRN

Në bazë të nenit 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenit 4, dhe neni 10 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 15.12.2016 merr këtë:

# VENDIM PRELIMINAR

## Neni 1.

**KONSTATOHET** se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1 deri 1.4, paragrafi 1 i nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, për shpronësimin e pronës së paluajtshme për qëllim të përfitimit të ligjshëm publik – realizimi i projektit për ndërtimin me kubëza betoni i trotuarit në rrugën "Arsim Muzaqi" në Vushtrri, Komuna Vushtrri për pjesën e parcelave kadastrale si në vijim:

- P-70202053-00207-0, në sipërfaqe prej **30 m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1663 m$^2$, ZK-Prelluzhë, pronar në pjesë ideale 1/1 Sefedin Rexhep Haradini nga Stanoci i Poshtëm, Komuna Vushtrri.
- P-70202053-00208-0, në sipërfaqe prej **10m$^2$**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1409 m$^2$, ZK-Prelluzhë pronar me pjesë ideale 1/1 Izet Brahim Igrishta nga Stanoci i Poshtëm, Komuna Vushtrri.

## Neni 2

Brenda 5 ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, do të njoftohet me vendimin preliminar pronari/zotëruesi i interesit të pronës e cila do të shpronësohet.

## Neni 3

Brenda 10 ditëve të punës pas miratimit, vendimi preliminar do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në Gazetën ditore "Kosova Sot" në Kosovë.

1322/16

28.12.2016

VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI**
**Kryetari i Komunës**

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Me këtë vendim formoj komisionin për zbrazje e të hollave të E-kioskut para hyrjes së objektit të komunës dhe atij në hapësirat e Qendrës për Regjistrim Civil në Vushtrri në këtë përbërje:

   1.1 Xhevdet Barileva, kryesues i komisionit
   1.2 Fatime Pantina, anëtare
   1.3 Shemsi Uka, anëtar

2. Komisioni në fjalë duhet të bëj zbrazjen e të hollave të E-kiosqeve të cekura në pikën një të këtij vendimi më së largu deri me datën 30.12.2016 nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe dorëzojnë në bankën përkatëse sipas ligjit, në Vushtrri.

3. Komisioni, me rastin e zbrazjes ë E-kiosqeve duhet të hartoj procesverbal për gjendjen e konstatuar dhe dorëzoj Zyrtarit kryesor financiar të komunës.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi iu dërgohet: anëtarëve të komisionit, zyrtarit kryesor financiar dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

VUSHTRRI - VUČITRN
1224/16
28.12.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M
## PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për regjistrim të gjendjes së arkës së komunës, në këtë përbërje:

    1. Mexhit Perquku, kryesues i komisionit
    2. Rexhep Gërguri, anëtar
    3. Besim Demiri, anëtar

2. Komisioni, në fjalë do të konstatoj gjendjen e vlerës monetare në arkën e komunës me datë 30.12.2016 në ora 12:00.

3. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

4. Vendimi iu dërgohet: anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
Nr./No./Br. 1227/16
Nr. i Fq./Br.str.
Datum/Datum 30.12.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. Lejohet pagesa e faturës nr.0123, datë 28 dhjetor 2016 në shumë prej 237.00 € (dyqindetridhjeteshtatë euro), për shpenzimet e krijuara në NH "Amazona" Muzakaj - Obiliq me stafin udhëheqës të komunës.

2. Pagesa të bëhet nga buxheti i zyrës së Kryetarit të Komunës, në numër të llogarisë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkëngjitura në shtojcë të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË / OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. 1223/16
Nr. i fq. / Br. st.
Date: / Datum 30.12.2016
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. Lejohet pagesa e faturës nr. 0693, dt. 29.12.2016 në shumë prej 1390.00 € (njëmijetreqindënëntëdhjetë euro), për shpenzimet e krijuara në NH "Amazona" Muzakaj, Obiliq – akomodim (fjetje, pansion i plotë) për 22 persona, poetesha nga trojet shqiptare të cilat kanë marrë pjesë në festivalin "Takimet e Poeteshave Shqiptare", mbajtur në Vushtrri në muajin nëntor 2016.

2. Pagesa të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në numër të llogarisë bankare të paraqitur në faturë e cila është e bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi ju dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Bajrum Mulaku